



## QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të Nenit 50 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02 dhe ""Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 202/24) dhe në lidhje me Nenin 20-g të Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19, 14/20 dhe 208/24, Qyteti i Shkupit shpall

### **SHPALLJE PUBLIKE nr.10/2024** **për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar**

Përcaktohet nevoja për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar në vendin e punës të mëposhtëm:

1. Emërtimi i vendit të punës **Sigurimi i objekteve**, shifra UPR0402A03001, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **Numri i përmbauesve (3)**.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

#### **Kushte të përgjithshme:**

- të jetë nënshtruar i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë madhore,
- të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim me ndalim kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

#### **Kushte të veçanta:**

- arsim fillor
- me ose pa përvojë pune

#### **Kushte të tjera të veçanta:**

- licencë për sigurimin e pronave dhe personave

Vlera në të holla e pagës bazë neto për vendin e punës **Sigurimi i objekteve** - është 33.609 denarë.

Orari i punës është me turne, nga e hëna të dielën, përkatësisht - 12 orë punë, 24 orë pushim, 12 orë punë, 48 orë pushim.

Kandidatët mund ta shkarkojë **APLIKACIONIN PËR PUNËSIMIN e personave ndihmës – teknik në Qytetin e Shkupit nr.10/2024** nga ueb faqja e Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) ose ta marrin në Arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr.16 në adresën bul. "Ilinden" nr.82, Shkup.

**Kandidatët janë të obliguar përveç aplikimit për punësim sipas shpalljes publike nr.10/2024, të depozitojnë biografi të shkurtër dhe letër motivimi të**

shkurtër, si dhe dëshmi të plotësimit të kushteve të mësipërme të punës (në origjinal ose kopje të noterizuar) si më poshtë:

- dëshmi për shtetësi;
- dëshmi se me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim me ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- dëshmi për përfundimin e nivelit adekuat të arsimit;
- dëshmi e aftësisë shëndetësore për vendin e punës;
- licencë për sigurimin e pronave dhe personave

Kandidatët, nëse kanë përvojë pune, duhet të depozitojnë dëshminë e përvojës së punës të regjistruar në Agjencinë e Punësimit.

Kandidatët e interesuar dokumentet e kërkuara duhet t'i depozitojnë në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr.16) ose në adresën bul. "Ilinden" nr. 82, Shkup, me shënimin - për **SHPLLJE PUBLIKE nr.10/2024 për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar.**

Afati i aplikimit është 7 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes publike. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e specifikuar në shpallje në momentin e depozitimit të aplikimit.

**Vërejtje:** Nëse kandidati në aplikim nuk ka depozituar të dhëna për kontakt (numër telefoni ose adresë e-mail) aplikimi do të refuzohet.

#### **Informacion për mënyrën e realizimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim:**

Faza 1: verifikimi i aplikimeve dhe dëshmime – realizohet në afat prej 3 ditësh nga dita e përfundimit të Shpalljes publike. Nëse mungon ndonjë dëshmi, Komisioni për përzgjedhje do të kontaktojë kandidatin nëpërmjet adresës e-mail ose numrit të telefonit në aplikim, dhe ai në afat prej tri ditësh duhet t'i kompletojë dëshmitë, në të kundërt aplikimi do të refuzohet. Aplikimi do të refuzohet edhe nëse dëshmia/dëshmitë janë të rreme.

Faza 2: verifikimi i aftësive fizike të kandidatëve për punësim të cilët kanë kaluar fazën e parë – realizohet në afat prej 10 ditësh pas realizimi të fazës së parë të përzgjedhjes.

Fazat e procedurës së përzgjedhjes janë rregulluar në **REGULLOREN për punësimin e personit ndihmës - teknik në Qytetin e Shkupit** nr.08-12594/1 datë 19.11.2024, e cila është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)).

**QYTETI I SHKUPIT  
KRYETARJA E QYTETIT TË SHKUPIT**